

Qëndrimi larg fitneve

Derë prej dyerve të lumturisë është dhe qëndrimi larg fitneve. Pejhamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***"Vërtet, i lumtur është ai që qëndron larg fitneve! Vërtet, i lumtur është ai që qëndron larg fitneve! Vërtet, i lumtur është ai që qëndron larg fitneve!"*** Fakti që e ka përsëritur tri herë, tregon për rëndësinë e asaj që shtjellon hadithi. Këtu shohim se ka një ndërlidhje të fortë mes arritjes së lumturisë dhe qëndrimit larg fitneve. Kush qëndron larg fitneve e nuk përfshihet në to, ka ndjekur një rrugë që dërgon drejt lumturisë. Hisja në arritjen e lumturisë, te njerëzit, është aq sa ata qëndrojnë larg fitneve. Sa më shumë që qëndrojnë larg tyre e nuk përfshihesh në to, për aq dhe do të arrijnë prej lumturisë. E sa më shumë që u afrohen atyre, aq do të kenë hise në mjerim e shkatërrim.

Ka ardhur dhe në një hadith: ***"Do të ndodhin fitne të shumta. Ai i cili qëndron ulur (në këto fitne), është më i mirë sesa ai që qëndron në këmbë. Ai që qëndron në këmbë, është më i mirë sesa ai që ecë. Ai që ecë (drejt fitneve) është më i mirë sesa ai që shpejton (në futjen në këto fitne)."*** Këtu shohim se sa më shumë që njeriu qëndron larg fitneve aq më shumë do të arrijë prej lumturisë dhe aq më shumë do të jetë më i shpëtuar prej shkatërrimit e humbjes. Kështu, ai që është në këmbë është më afër fitneve sesa ai që është ulur, ai që ecë (drejt fitneve) është më afër fitneve sesa ai që është në këmbë dhe ai

që shpejton të futet në fitne është më afër shkatërrimit dhe fitneve sesa ai që ecë drejt tyre.

Çdo musliman që ia do të mirën vetes dhe të tjerëve duhet të veprojë shkaqet që ia sjellin lumturinë vetes së tij dhe atyre, gjithashtu t'i këshillojë dhe ata në ndjekjen e këtyre shkaqeve. Dhe nuk duhet ndjekur shkaqe që çojnë në shkatërrime e mjerim. E shkaku më i madh në këtë është nxitja dhe nderja e fitneve në mesin e muslimanëve.

Në bazë të hadithit që përmendëm, kuptojmë se hyrja në fitne është graduale (kalon nëpër faza). Së pari, personi është i ulur, e kur synon të hyjë në fitne ngritët në këmbë, pasi ngritët fillon të ecë (drejt tyre), e kur fillon të ecë edhe do të shpejtojë në hyrjen në to, duke mos e kthyer më kokën pas, pra nuk i kushton rëndësi këshillave e qortimeve që i vijnë për rrugën e gabuar që është duke ndjekur. Fatkeqësia më e madhe është kur arrin këtë nivel: kur zemra e tij veçse e ka thithur fitnen dhe është mbushur me të. **"që shpejton"**- tashmë shkon vetëm sipas tekave të tij, sipas asaj që e thirr nefs i e pasionet e tij, ndërkohë që as ajetet, hadithet apo fjalët e dijetarëve nuk i bëjnë dobi më.

Kur shfaqen fitnet zemrat ndahen në dy lloje:

1. Zemrat që i pranojnë fitnet, kthehen kah to, jepen pas tyre, përfshihen në to dhe janë të kënaqura me to.
2. Zemrat që nuk i pranojnë fitnet, i refuzojnë dhe largohen prej tyre.

Disa shkaqe me të cilat ruhem i prej fitneve

1. *Frika ndaj Allahut (devotshmëria)*. Te frika ndaj Allahut është shpëtimi. Kush e ka frikë Atë, Ai e ruan dhe e udhëzon drejt çdo mirësie, në çështjet e fesë dhe të dunjasë. Allahu ka thënë: **“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret.”** Talak 2-3. Dhe: **“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’ia lehtësojë çështjen.”** Talak 4. Të tillin Allahu do ta ruajë nga fitnet, do ta ruajë nga të gjitha anët, që të mos jetë pjesë e fitnes. Disa njerëz në kohën e tabiinëve kanë ardhur tek Talk ibn Habib rahimehullah kur ka ndodhur fitneja e havarixhëve dhe i kanë thënë: *"Fitneja po shohim se ka ndodhur, por si të ruhem i prej saj?"* Ai ka thënë: *"Rubuni prej saj me frikë ndaj Allahut (me devotshmëri)!"* - *"Na përmbledh atë (se çfarë është)!"* - *"Frika ndaj Allahut është të adhurosh Atë me dritë prej Tij (me argumente), duke shpresuar shpërblimin e Tij, dhe të braktisësh mëkatet me dritë prej Tij (me argumente), duke pasur frikë dënimin e Tij."* Shumë dijetarë e kanë lavdëruar shumë këtë definicion të devotshmërisë. Devotshmëria nuk është thjeshtë një pretendim, por ajo është dije, punë, shpresë dhe frikë; është pra veprim i urdhrave të Allahut dhe largim nga mëkatet. Kur njeriu ka frikë Allahun, Ai patjetër do ta shpërblejë: do ta ruajë, mbrojë dhe shpëtojë prej fitneve. Përfundimi i lumtur u takon të devotshmëve, siç e kuptojmë këtë nga ajetet dhe hadithet.

2. *Kapja pas Kuranit dhe sunetit.* Allahu thotë: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!”** Ali Imran 103. Porse, kjo nuk është thjeshtë të lexojë librin e Allahut pa e kuptuar e pa i ditur domethëniet e tij dhe pa punuar me udhëzimet që janë zbritur në të. Kurani është zbritur që të meditojmë në të dhe të punojmë me mësimet e tij, **“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.”** Sad 29. Imam Malik ibn Enes rahimehullah ka thënë: *"Suneti është sikur anija e Nubit. Kush hip në të, ka shpëtuar. E ai që e largohet, është i shkatërruar."* Ka shpëtuar prej dallgëve të shumta të fitneve që e rrethojnë atë dhe muslimanët, vazhdimisht, prej pas vdekjes së Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem deri në Ditën e Kiametit. Sa më afër kësaj Dite, fitnet do të shtohen më shumë. Ku është shpëtimi? *Tek kapja pas Kuranit e sunetit.* E kush largohet, është i shkatërruar sepse e përfshijnë dallgët e fitneve.

3. *Durimi, ndalja e vetes, e jo të nxitojë të hyjë në fitne.* Aliu radijAllahu anhu ka treguar (siç ka dëgjuar prej Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem) se do të ndodhin fitne gjithëpërfshirëse, që nuk largohen për një kohë të gjatë, të rënda e të forta, dhe na ka porositur: *"Mos u bëni prej atyre që shpejtojnë të hyjnë në to dhe që i përhapin ato!"* Ai që nuk ngutet, duke qenë durimtar, ka shpëtuar. Ibn Mesudi radijAllahu anhu ka thënë: *"Do të ndodhin gjëra (fitne) që paqarta për besimtarin (nuk e di se çfarë të veprojnë në*

to). *Andaj mos u ngutuni, ngase që të jesh pasues në të mirë, në fund të karvanit, kjo është më mirë sesa të jesh i pari në të keqe.*"

4. *Marrja e dijes prej dijetarëve të mëdhenj, të cilët janë të thelluar e të pa lubatur në dije.* Selefî ka thënë: "Bereqeti është me dijetarët e mëdhenj." Këta janë ata që kanë largpamësi, qëndrueshmëri në dije, që përmenden për dije. Sa herë që besimtari qëndron pas tyre, u referohet e u kthehet atyre, do të jetë gjithmonë në mirësi. Njerëzit e fitnes hapin e parë që e veprojnë ndaj të rinjve të cilët duan t'i fusin në fitne, është shkëputja e lidhjeve mes tyre dhe dijetarëve, që të mos dëgjojnë prej tyre. Kështu u flasin kundër tyre, gënjejnë e shpifin, i kritikojnë, duke futur në zemrat e këtyre të rinjve urrejtje për ta dhe mospranim të tyre. Këtë edukatë të përmendur në këtë pikë, e ka përmendur Allahu në Kuran: "**Kur atyre¹ u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por, në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë (dijetarëve), hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo).**" Nisa 83.

5. *Mbyllja e rrugëve dhe dyerve përmes të cilave fitneja depërton tek ti.* Në këtë mënyrë do të shpëtosh. Besimtari duhet të mbyllë derën e të keqes, të mos e lërë hapur, të mos e lërë mundësinë e të shikuarit në të dhe të dëgjuarit të saj, e nga ana tjetër duhet të shpresojë shpëtimin.

¹ Hipokritëve, fitnegjive.

Shumë të rinj klikojnë në internet dhe lexojnë, e thonë: "Veç dua të di se çfarë thonë!" apo: "Të shoh se cilat janë argumentet e tyre." Porse, le të dijë se ky është fillimi i shkatërrimit të tij. Kjo është fillesa drejt fitnes. E pastaj pas një kohe ato gjëra (që lexon) do të depërtojnë në shpirtin e tij, derisa t'ia verbojnë zemrën, ndonëse ky nuk ka qenë qëllimi i tij. Besimtari duhet të dijë se është miskin, i mjerë, nëse nuk e ruan Allahu devijon shumë lehtë, andaj nuk duhet ta ekspozojë veten para fitneve, duke thënë: "Kam dije të mjaftueshme. Vetëm të shoh se si argumentohen ata e këta." Kështu. vetë i riu ia hap vetes dyert e depërtimit të fitnes, e pastaj njerëzit e fitneve hedhin helmin dhe ideologjitë e tyre në zemrat e tij. Zemrat u shfaqen fitneve përmes dëgjimit dhe shikimit.

6. *Lutja tek Allahu për mbrojtje nga fitnet.* Lutja është çelësi i çdo të mire. Muslimani duhet që sa më shumë, sidomos sot kur fitnet janë shtuar, që ta lusë Allahun ta ruajë dhe mbrojë prej fitneve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "***Kërkoni mbrojtje tek Allahu prej fitneve, të dukshme e të fshehta!***" Muslimi. Allahu nuk e refuzon lutjen e besimtarit, nuk e zhgënjën atë i cili kërkon ndihmë e mbrojtje prej Tij. Allahu thotë: "**Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!"**" Gafir 60. "**Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua."** Bekare 186. Kush është i sinqertë e i vërtetë me Allahun, kur e lut Atë, kur i drejtohet, kur kthehet tek

Ai dhe kur kërkon tek Ai mbrojtje që ta ruajë prej fitneve, me ngulm dhe vazhdimisht, Allahu gjithsesi do t'i përgjigjet dhe do ta ruajë prej fitneve me mirësinë dhe dhuntinë e Tij.

Hoxhë Lulzim Perçuku – Dersi “I lumtur është ai që qëndron larg fitneve”.